



Më
Data

28-09-18

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:018680

Datë: 15.08.2018

Numri i dokumentit: 00101480

P.nr.2258/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe bashkëpunëtoren profesionale Mimoza Shabani, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Shtime, për shkak të veprës penale tregim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.2112-4/16 e dt.06.09.2017, në prezencën e prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED] pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 13 Korrik 2018 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25 Korrik 2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarin: [REDACTED] i lindur me dt [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Fsh. [REDACTED] K. Shtime, i martuar, prind i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me profesion mjeshtër në ndërtimtari, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt.31.10.2016, rreth orës 08:00, në Fsh. Muzeqinë K. Shtime, duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes MB 100", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] në kundërshtim me dispozitat e nenit 46.1 të LSKRR nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, duke venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke mos siguruar mirë me këtë veprim rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, duke kaluar në shiritin e kundërt qarkullimin, godet automjetin e markës "VW Golf", me targe të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilin e drejtonte [REDAKTUAR] ku pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pësojnë, [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] si dhe [REDAKTUAR] të përshkruar si në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 14.08.2017.

me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 41, 46, dhe 73 e 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit [REDAKTUAR] e,

G J Y K O N

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) Muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 /një/ Viti, nëse i pandehuri nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nuk kryen vepër tjetër penale.
- Te dëmtuarit: [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 Euro /njëzet/ si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumë prej 90.88 Euro /nëntëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, në afatin prej 30 ditëve pasi aktgjyqimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr2112-4/16 e dt.06.09.2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.07.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuzat sipas të gjitha pikave, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë aksident, ku me të dëmtuarit është familjar të cilët punojnë në ndërtimtari dhe nga kjo punë sigurojnë jetesën dhe mbajnë familjen, kërkon nga gjykata që të këtë parasysh këto rrethana dhe të i shqiptoj një dënim sa më të bute.*

Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që të akuzuari kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të

Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, Ekspertiza Mjeko-Ligjore me nr. reference FE-592/17 e dt.14.08.2017, Ekspertiza e Komunikacionit e dt.02.08.2017, Raporti i Aksidentit 2016-CFT-653 i dt.31.10.2016, deklarata e te dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt.31.10.2016 si dhe fotografitë dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
- me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si G.JA.nr. 207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim të diapozitivit të aktgjykimit: dt.31.10.2016, rreth orës 08:00, në Fsh. Muzeqinë K. Shtime, duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes MB 100”, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] në kundërshtim me dispozitat e nenit 46.1 të LSKRRR nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, duke venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke mos siguruar mirë me këtë veprim rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, duke kaluar në shiritin e kundërt qarkullimin, godet automjetin e markës “VW Golf”, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilin e drejtonte [REDAKTUAR], ku pos dëmeve

materiale, lëndime të lehta trupore pësojnë, [REDACTED] [REDACTED] si dhe [REDACTED] të përshkruar si në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 14.08.2017.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së të KPRK-së, të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata ndaj të akuzuarve si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, rrethana lehtësuese i morri premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëritin vepra penale, nuk ka dëshmi se vërtetohet që është gjykuar me vendim të formës së prerë, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që të përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 458 dhe nenit 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Numri i lëndës: 2018.018680
Datë: 15.08.2018
Numri i dokumentit: 00101480

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2258/17 e dt. 25.07.2018

Bashk.Profesionale:

Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.